



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 06.10.2022 dhe datë 10.10.2022.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Shtator 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
6. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “DIMAX” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
7. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “ERNI SOLAR” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
9. Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 250, datë 13.12.2022, mbi rishikimin e vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar” dhe rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 164, datë 20.06.2022, mbi transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., nr. 49, Seria NPM07P, dhënë me vendimin e bordit nr. 61, datë 02.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar.

10. Mbi rishikimin e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021 “Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-VENTO S.R.L ALBANIA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 32, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-VENTO S.R.L ALBANIA” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar”.